



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3704

NR. VENDIMI 1383



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Nr: 14063/3704 Regj. Themeltar

Nr: 1383 Vendimi

VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqesore **Gencjana Dada**, sot më datë **27. 02. 2017**, mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjes civile me **Nr. 14063/3704 Regj. Themeltar** që i përket :

PADITES:

SHOQERIA ***, me seli ne *******, e perfaqesuar ne gjykim me prokure te posaçme dt. ******* nga ******* dhe me autorizim perfaqesimi te leshuar nga ky i fundit dt. ******* edhe nga av. *******.

I PADITUR:

SHOQERIA ***, me seli ne ******* (ne mungese me shpallje).

OBJEKTI:

1. Ç’regjistrimi i makes tregtare Fast Dairy (fjalë&figurë), me regjistrim kombëtar Nr. *******, regjitruar ne emer te te paditurit shoqeria ******* per shkak se eshte konfuzisht e ngjashme me marken e meparshme, Fast dairy ne pronesi te paditesit.
2. Ç’regjistrimi i emrit tregtar dhe emrit te shoqerise te te paditur ******* nga Regjistri Tregtar per shkak te ngjashmerise pothuajse identike me marken e paditesit.
3. Ndalimin e perdorimit te metejshem te markes Fast nga i padituri.
4. Publikimin e ketij vendimi ne Buletinin e Pronesise Industriale te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe

Markave.

BAZA LIGJORE:

Nenet 143, 173, Neni 184 (2) e vijues të ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Pika 28 e VKM-se Nr. 537 dt. 01. 08. 2007 “Per rregullat per emrat dhe emertimet tregtare”. Neni 348 i K. Pr. Civile.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesueses se pales paditese, e cila kërkoi: *Pranimin e kerkese padise sipas objektit te saj*, pasi e shqyrtoi çeshtjen ne teresi ne mungese me shpallje te pales se paditur, në përfundim të shqyrtimit gjyqesor,

VEREN :

Se, paditesi shoqeria ***, nepermjet perfaqesueses se saj i është drejtuar kesaj gjykate, me kërkesë-padine me objektin e siperpermendur.

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kesaj çeshtjeje te paraqitur per gjykim dhe bazuar ne Nenet 36, 59 te K. Pr. Civile, konstatoi se çeshtja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë të Nenin 41 të K. Pr. Civile : *”Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera”*. Meqënëse ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje me karakter tregtar që rrjedh nga marrëdhënia juridiko-tregtare e pronësine mbi markat, gjykata referuar dhe Neneve 334-335 te K. Pr. Civile çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencen tokesore ne bazë të Nenit 43 të K. Pr. Civile, *“Kur i padituri eshte person juridik paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka qendren e tij...”*. Nga ana tjetër neni 348 i K. Pr. Civile percakton se : *«Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjt tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod”*.

Sa me siper, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane per shqyrtimin e kesaj çeshtjeje objekt konflikti.

Pala paditese, bazuar ne Nenin 32/a te K. Pr. Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykates me kete kerkese-padi ne baze te se ciles do te perfitoje te drejta personale - pasurore.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të Neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga pala prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Paditesi, shoqeria *** është shoqeria meme dhe kryesuese e grupit të shoqerive *** e cila e ka selinë në ***. Shoqeria e parë e grupit *** daton e themeluar mbi 125 vjet përpara në Gjermani dhe ka zhvilluar aktivitetin e saj gjatë gjithë këtyre viteve në tregun e prodhimit të produkteve blegtorale.

Nga ana tjetër shoqeria *** dhe ajo është subjekt i së drejte tregtare shqiptare dhe ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj në dt. *** ku si objekt të veprimtarisë së saj ndër të tjera ka dhe: *“import dhe eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë si dhe prodhim dhe perpunim i qumështit dhe gjithë nënprodukteve të tij”*.

Në gjykim pala paditese shprehu rreth objektit të kerkese-padise se ai duhet pranuar si i tillë në teresinë e tij për arsye se:

Shoqeria *** (paditësi), zotëron dhe ka në pronësi markat ndërkombëtare:

- Marka fjalë dhe figurë- regjistrim ndërkombëtar me numër ***, e vlefshme në Shqipëri nga data 23. 05. 2011 – e regjistruar në klasat 29, 30 dhe 32; dhe;
- Marka fjalë - Fast Dairy - regjistrim ndërkombëtar me numër ***, e vlefshme në Shqipëri nga data 24. 06. 2011 – Fast Dairy, e regjistruar në klasat 29, 30 dhe 32.

Paditesi, *** ka fituar dhe regjistruar të drejtat e tij mbi markat e sipërcituara në Shqipëri duke ushtruar të drejtën e prioritetit në përputhje me nenin 147 të ligjit me Nr. 9947, datë 07. 07. 2008 “Për Pronësinë Industriale”.

Sipas kësaj dispozite, *pronari i një marke mund të ushtrojë të drejtën e prioritetit brenda gjashtë muajve nga data e depozitimit të aplikimit të parë për regjistrimin e markës përkatëse, me qëllim shtrirjen dhe regjistrimin e kësaj marke edhe në shtete të tjera.*

Më tej, në nenin 147/2 të ligjit për pronësinë industriale parashikohet se *“... data e prioritetit quhet si datë depozitimi e aplikimit për regjistrimin e markës pranë DPPM me qëllim për të përcaktuar se cili aplikim gëzon një të drejtë të mëparshme”*.

Pra, data e depozitimit të aplikimit të parë për regjistrim në vendin e origjinës (data e prioritetit) është data nga kur fillon vlefshmëria e markës në Shqipëri dhe është kjo datë depozitimi që konsiderohet për të vlerësuar të drejtën e mëparshme të markës në Shqipëri.

Gjithashtu, sipas nenit 143/5/a i ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale, një markë e mëparshme, vlerësohet marka me një datë aplikimi për regjistrim më të hershëm sesa data e aplikimit për regjistrim të një marke tjetër tregtare, duke konsideruar sipas rastit pretendimin për prioritet të markës përkatëse.

Konkretisht, *** ka depozituar aplikimet e para për regjistrimin e markave Fast Dairy pranë Zyrës së Markave në Kroaci, respektivisht, për markën me Nr. *** më datë 23. 05. 2011 dhe për markën me Nr. *** më datë 24. 06. 2011.

Më pas brenda afateve ligjore ka aplikuar për shtrirjen dhe regjistrimin e markave në fjalë edhe në Shqipëri, duke ruajtur si datë depozitimi të aplikimit datën e aplikimit të parë në vendin e origjinës

(Kroaci), pra, marka Fast Dairy (fjalë dhe figurë) mban datë depozitimi 23. 05. 2011 dhe marka Fast Dairy (fjalë) mban datën e depozitimit 24. 06. 2011 siç pasqyrohet edhe në pikat 300 dhe 834 të ekstrakteve për regjistrimin ndërkombëtar të markave Fast Dairy.

Ndërkohë pala e paditur shoqëria *** ka regjistruar markën kombëtare FAST Dairy (fjalë dhe figurë) numër ***, për klasën 29, me datë aplikimi për regjistrim 18. 11. 2011 dhe datë regjistrimi 29. 05. 2012, siç provohet nëpërmjet ekstraktit të lëshuar nga DPPM.

Sa me sipër të dhenat e markave të paleve ndërgjyqëse paraqiten si të tilla;

<u>Markat e paditësit</u>	<u>Marka e të paditurit</u>
<u>Markë ndërkombëtare ***</u>	<u>Marka kombëtare ***</u>
<u>Data e depozitimit: 23.05.2011</u>	<u>Data e depozitimit:</u>
<u>18.11.2011</u>	

Markë ndërkombëtare *** - FAST DAIRY
Data e depozitimit: 24.06.2011

Sa me sipër, data e aplikimit për regjistrim të markës së të paditurit është 18. 11. 2011, kurse data e aplikimit për regjistrim të markës së parë të paditësit është 23. 05. 2011. *Pra, paditësi ka aplikuar për regjistrim për markën e tij 6 muaj përpara të paditurit duke fituar të drejtat e një marke të mëparshme.* Për këtë arsye, konform nenit 143/5/a të ligjit për pronësinë industriale, paditësi legjitimohet në të gjitha të drejtat e një marke të mëparshme për të kundërshtuar dhe kërkuar ç'regjistrimin e markës së mëvonshme të të paditurit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 173/1 i ligjit specifik parashikon se pronari i një marke kërkon në rrugë gjyqësore ç'regjistrimin (shfuqizimin) e një marke tjetër të regjistruar në kundërshtim me nenet 142 dhe 143.

Sipas nenit 143/2/b të ligjit specifik një markë e mëvonshme duhet të çregjistrohet nëse ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit të publiku, duke përfshirë këtu mundësinë e bashkëlidhjes së markës së mëvonshme me markën e mëparshme. Në këtë nen përcaktohen kushtet ligjore që duhet të përmbushen me qëllim përcaktimin e mundësisë për konfuzion. Këto kushte janë: ngjashmëria mes shenjave dhe ngjashmëria mes mallrave/shërbimeve.

Nga ana tjetër, praktika gjyqësore ka zhvilluar më tej dispozitat ligjore të sipërcituara duke përcaktuar/shtuar edhe kushte të tjera që evidentojnë mundësinë për konfuzion të tillë si: publiku përkatës dhe shkalla e vëmëndjes së tij, karakteri dallues dhe dominant i markave në diskutim, fuqia e markës me reputacion, duke vënë theksin tek një vlerësim gjithëpërfshirës së mundësisë për konfuzion dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve.

Nga krahasimi i markave në diskutim, sipas pales paditëse provohet lehtësisht njëlllojshmëria dhe ngjashmëria e mallrave dhe shenjës që marka

e të paditurit ka me markën e paditësit.

• Krahasimi i mallrave

Markat në diskutim janë të regjistruara të dyja në klasën 29.

I padituri ka regjistruar markën e kundërshtuar në klasën 29 për mallrat: bulmetra, djathë, gjalpë, pije qumështi, të mbizotëruara nga qumështi, produkte qumështi, qumësht, qumësht soje, kos të të gjitha llojeve përfshirë edhe kosin me fruta, mocarela, gjizë e rikotë, si dhe çdo nënprodukt tjetër pa kufizim.

Ndërkohë edhe paditësi ka të regjistruar e tij në klasën 29 për mallrat: **qumështi dhe produktet e tij**; vajra ushqimore dhe yndyrna; *salcë ose pastë me bazë qumështi, proteina, yndyrna; salcë ose pastë me bazë proteina soje për qëllime ushqimore; agjentë për kafe dhe çaj, të përbërë kryesisht nga karbohidrate, proteina dhe/ose yndyrna; gjalp kakao; ëmbëlsira të gatshme ose të pluhurosura dhe gatime të ngjashme me bazë qumështi; supra; hirrë për qëllime ushqimore; hirrë, sheqer qumështi, kazeinë, koncentrate frutash ose proteinash për qëllime ushqimore; duke përfshirë të gjithë mallrat e sipërcituar gjithashtu në formë pudre për qëllime ushqimore; lëngje frutash dhe perimesh për gatim; marmaladë, reçel; pudër yndyrnash shtazore dhe/ose vegjetale (yndyrna shtazore); **gjalp** dhe përgatije gjalpi, kremra, produkte kremoze, produkte kremoze vegjetale, qumësht i prerë, **kos, pije kosi**, qumësht pa laktozë, produkte qumështi pa laktozë, krem për kafe, imitime djathi, hirrë, **gjizë, djathë**, meze frutash, **qumësht soje**, krem i mpiksuar, **pije qumështi të mbizotëruara nga qumështi**, margarinë, gjalp kakao, kazeinë për qëllime ushqimore, sallatë frutash, xhel frutash*

Nga krahasimi i listave përkatëse të mallrave, rezulton fare qartë se mallrat **qumësht e nënproduktet e tij, gjalp, kos, gjizë, djathë, qumësht soje, pije qumështi**, të shenjura edhe më sipër janë produkte të cilat të gjitha përkujnë dhe janë identike në terma me mallrat e mbrojtura nga marka e paditësit. Përsa i përket termave mocarela dhe ricota të cituara në mallrat e klasës së të paditurit, këto dy terma janë lloj djathi dhe gjize ndaj janë të mbuluara nga mallrat e klasës së paditësit. Lidhur me fjalën bulmetra, kjo është kategori e mallrave e cila gëzon mbrojtje nga klasa 29 nën mbrojtje nga marka e paditësit.

Duke u nisur edhe nga praktika e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian, si organi kompetent për trajtimin e çështjeve të pronësisë industriale në vendet e BE, nëse nga krahasimi i markave në diskutim rezulton se termat e mallrave objekt krahasimi përkujnë, atëherë njëllojshmëria e mallrave është e evidente. Gjithashtu, kjo njëllojshmëri e evidentohet nëse mallrat e markës së kundërshtuar përfshihen në kategorinë më të gjerë të markës kundërshtuese ose anasjelltas (çështja T-522/10 'Hell', datë 17/01/2012, paragrafi 36 i GJDBE).

Sa më lart, provohet fare qartë se mallrat e markës së të paditurit përkujnë në tërësi në terma me mallrat e markës së paditësit, si dhe mallrat e markës së kundërshtuar përfshihen në kategorinë e gjerë të markës së të paditurit (qumësht dhe nënproduktet e tij).

Rrjedhimisht, arrihet në përfundimin se *mallrat në diskutim janë identike*.

• Krahasimi i shenjave

Shenjat-markë objekt i krahasimit janë:

Markat e paditësit

Marka e të paditurit

Markë ndërkombëtare ***

FAST DAIRY

Marka kombëtare ***

Markë ndërkombëtare ***

Aspekti vizual - Krahasimi i shenjave-markë realizohet bazuar në aspektin vizual (çfarë shikojmë), fonetik (çfarë shqiptojmë) dhe konceptual (çfarë dëgjojmë apo përcjellim në mendje). Gjetja e ngjashmërive qoftë në njërin nga komponentët objekt krahasimi – vizual, fonetik, apo konceptual – përbën bazë të mjaftueshme për t'i konsideruar shenjat e ngjashme, dhe për të provuar mundësinë për konfuzion (*çështja e GJDBE, C-251/95 Sabçl BV v Puma AG, parag. 22*).

Vlen për tu theksuar se krahasimi i shenjave-markë duhet të bazohet në përshtypjen e përgjithshme që markat krijojnë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë elementëve të tyre dallues dhe dominant (*çështja e GJDBE C-251/95, Sabçl dt.11/11/1997, EU:C:1997:528, parag. 23*).

Në rastin objekt shqyrtimi, nga ana vizuale elementi dallues midis markave në diskutim është elementi verbal FAST, i cili është vendosur në plan të parë pamor dhe zë pozicionin parësor/kryesor, duke patur shkallën më të lartë vizuale, në krahasim me elementët e tjerë përbërës të markave në diskutim. Gjithashtu, fjala FAST ka karakter dominant, për shkak të madhësisë dhe ngjyrës së kuqe të shkronjave që janë të njëjta tek të dyja markat. Është kjo fjalë që krijon përshtypje tek konsumatori dhe mbetet në kujtesën e tij. Përdorimi i kësaj fjale identike nga i padituri në markën e tij e bën këtë markë konfuzisht të ngjashme me markën e paditësit.

Lidhur me pjesën tjetër të elementëve përbërës të markës së të paditurit – elementi verbal “*dairy*”, i cili gjendet gjithashtu edhe në markën e paditësit, ky element jep informacion lidhur me kategorinë e mallit dhe si i tillë është element me karakter përshkrues (*dairy* - blegtori). Gjithashtu, raporti i tij me pjesën tjetër të markës është i ulët, dhe si i tillë është element që mund të mos konsiderohet në krahasimin e shenjave.

Fraza “*Dairy delights from Albania*” (produkte blegtorale nga Shqipëria) e përdorur në markën e të paditurit, përbëhet nga fjalë që përcjellin informacion mbi llojin e produktit (*dairy delights* – produkte blegtorale) dhe mbi origjinën gjeografike të produktit (*from Albania* – nga Shqipëria). Këto fjalë përshkruese janë të përjashtuara nga mbrojtja e markës së të paditurit (siç konstatohet edhe në ekstraktin e DPPM pika 526 të depozituar në gjykatë), ndaj duhet të neglizhohen.

Më tej, ngjyrat që mbrohen dhe përdoren nga i padituri në prezantimin e markës së tij janë të njëjtat me ngjyrat e mbrojtura dhe të

përdorura në markën e paditesit, të tilla si: *e kuqe, e bardhë, blu*. Përdorimi i të njëjtave ngjyrave shkakton konfuzion tek konsumatori nga ana vizuale.

Së fundmi, dhe pse marka e kundërshtuar përbëhet nga elementë figurativë dhe është e stilizuar, ky fakt nuk luan një rol të rëndësishëm në përshtypjen e përgjithshme që kjo markë krijon, pasi rezulton e qartë se çfarë mbetet për tu krahasuar është vetëm elementi verbal FAST, i cili shkruhet me të njëjtën ngjyrë dhe krijon të njëjtin efekt vizual tek të dyja markat.

Elementi që mbetet për tu krahasuar është elementi verbal FAST i cili është edhe elementi dallues nga pikëpamja vizuale ndër të gjithë elementët e tjerë, duke arritur në përfundimin se markat në diskutim janë konfuzisht të ngjashme.

Aspekti fonetik – nga ky aspekt markat janë identike. Ato përbëhen nga të njëjtat fjalë FAST, fjalë e cila lexohet dhe shqiptohet nga konsumatori shqiptar njësoj. Prezenca e fjalës “*Dairy*”, për arsytet e shpjeguara më lart, mund të mos konsiderohet nga konsumatori, megjithatë edhe kjo fjalë përshkruese e mallit lexohet njësoj nga konsumatori (deiri). Përsa i përket frazës “*Dairy delights from Albania*” (produkte bulmeti nga Shqipëria), kjo frazë duhet të neglizhohet pasi nuk gëzon mbrojtje nga marka e të paditurit.

Pra sa më lart, ngjashmëria e markave në diskutim është tepër e lartë. Kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 143/2/b të ligjit specifik janë përmbushur: mallrat e markës së të paditurit janë identike me mallrat e markës së paditësit (klasa 29- kategoria qumësht dhe nënprodukte të tij) dhe shenjat përbërëse të markave kanë një ngjashmëri ekstremisht të ngjashme, pothuajse identike. Në kushtet kur kemi mallra identike dhe markat ekstremisht të ngjashme, mundësia për konfuzion është tepër e lartë dhe konsumatori konfondohet menjëherë. Për më tepër që me ngjashmërinë e tyre këto marka të krijojnë përshtypjen se janë të bashkëlidhura me njëra-tjetrën dhe vijnë nga e njëjta shoqëri, fakt që nuk është aspak i vërtetë.

Vëmendja e konsumatorit – Një faktor që ndikon drejtpërdrejt dhe duhet vlerësuar tek mundësia për konfuzion e markave në diskutim është vëmendja e konsumatorit. Nëse niveli i vëmendjes së konsumatorit është i ulët, ndryshimet midis markave nuk do të dalloheshin, sidomos për produkte të konsumit masiv, ku niveli i vëmendjes së konsumatorit ulët edhe më shumë. Vendimi i konsumatorëve për të blerë këto lloj produktesh është i menjëhershëm, merret në çast dhe pa reflektuar (çështja C-342/97 Lloyd Schuhfabrik Meyer & Co. GmbH v Klijsen Handel BV të GJDEV).

Mallrat nën markat në diskutim (qumësht dhe nënprodukte të tij), janë mallra të konsumit të përditshëm dhe të shpejtë që përdoren nga konsumatori i zakonshëm. Një konsumator i zakonshëm ruan në mendjen e tij një pamje jo perfekte të markave, të krijuar në atë çka ka dalluar zakonisht, që në rastin konkret është fjala FAST siç është shpjeguar edhe më sipër dhe e ka shumë të lehtë të konfundohet. Kjo nënkupton se ngjashmëritë mes shenjave do të mbeten në mendjen e konsumatorëve më shumë se diferencat që janë të një rëndësie shumë të vogël.

Nga ana tjetër, këto mallra tregtohen në të njëjtat pika shitjeje, dyqane

apo supermarke me produkte ushqimore dhe brenda këtyre dyqaneve stivohen dhe vihen në të njëjtët sektorë ku mbahen produktet dhe nënproduktet e qumështit. Diferenca midis markave në diskutim (së paku nga ana vizuale) është aq e vogël, pothuajse e pamundur, aq sa tepër e vështirë për tu dalluar nga konsumatori në jetën e përditshme. Secili prej konsumatorëve lehtësisht në momentin e përzgjedhjes do të besonte që këto mallra janë mallra të njëjta apo që kanë origjinë të njëjtë, duke u prodhuar nga e njëjta shoqëri fakt që nuk është aspak i vërtetë.

Konkretisht, konsumatori i mallrave të markës Fast Dairy është publiku i zakonshëm i produkteve dhe nënprodukteve të qumështit, të cilat konsumon shpejt dhe çdo ditë. Për më tepër që këto produkte për nga vetë natyra dhe përdorimi i tyre ofrohen kundrejt një çmimi të ulët dhe të përbalueshëm nga të gjithë. Si pasojë, në përzgjedhjen e këtyre produkteve konsumatorit i duhen shumë pak kohë për të vendosur duke e ulur nivelin e vëmendjes së e tij në minimum.

*Përdorimi i markës- Paditësi, shoqëria *** zotëron në Shqipëri shoqërinë e saj ***. (siç provohet në ekstraktin lëshuar nga QKB). Gjithashtu, *** zotëron në Shqipëri fabrikën e saj të ndodhur në Rrogozhinë, Kavajë, ku kanë punuar më shumë se *** punonjës për prodhimin dhe tregtimin e produkteve të qumështit si qumësht, djathë, gjalp, gjizë, etj.*

**** ka tregtuar në mënyrë aktive produktet e saj nën markën Fast Dairy prej më shumë se 5 viteve në Shqipëri. Me qëllim pasqyrimin në mënyrë të përmbledhur të aktivitetit në Shqipëri, administratori i *** z. *** ka lëshuar një Deklaratë datë *** ku pasqyrohet përdorimi i markës dhe produkteve nën këtë markë. Në mbështetje të të dhënave të paraqitura në deklaratë, paditësi ka depozituar gjithashtu si prova në gjykatë, pasqyrat financiare nga viti 2011 deri në vitin 2015, kontrata me distributorë në Shqipëri si dhe deklarata importi të produkteve nën markën Fast Dairy nga viti 2011 deri në vitin 2015.*

Specifikisht, produktet nën markën Fast Dairy janë tregtuar gjatë këtyre 5 viteve të fundit pothuajse në të gjithë rrjetet e supermarketeve në Shqipëri si Big Market, Eco Market, etj, siç rezulton nga të dhënat e paraqitura në pasqyrat financiare të 5 viteve të fundit, konkretisht në zërin “Llogaritë e arkëtueshme” të bilancit ku pasqyrohen volumi i furnizimeve dhe blerjeve nga palë të treta.

Gjithashtu, tregtimi i produkteve nga paditësi është realizuar në dy forma, nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes, një strukturë e ngritur brenda shoqërisë me rreth 20-25 persona të punësuar nga *** dhe nëpërmjet distributorëve, siç provohet edhe në kontratën e shpërndarjes datë 01. 08. 2011 të lidhur me *** dhe kontratën e furnizimit datë 25. 06. 2013 të lidhur me *** sh.p.k. Specifikisht, në kontratën me *** sh.p.k, ky i fundit ka kryer shitjen e produkteve FAST pothuajse në të gjithë territorin e Shqipërisë bazuar në objektivat për volumin e shitjeve të përcaktuara në këtë kontratë (neni 15 i kontratës).

Më tej, përdorimi i markës Fast Dairy provohet edhe nga importet e kryera në Shqipëri nga *** të paketimeve nën këtë markë nga nënkontraktori i saj ***, siç provohet në faturat dhe deklaratat e importit të paraqitura në gjykatë.

Nga faktet dhe të dhënat e paraqitura me sipër provohet në mënyrë të pakontestueshme se marka Fast Dairy është një markë aktive dhe me përdorim të gjerë në treg, duke qenë në gjendje të kundërshtojë markën e të paditurit dhe të kërkojë ç'regjistrimin e saj.

Lidhur me çeshtjen e ç'regjistrimit të emrit tregtar dhe emrit të shoqërisë
***.

Neni 23 i ligjit për QKR dhe ligji në përgjithësi nuk rregullojnë shprehimisht dispozitat mbi çregjistrimin e emrave tregtarë dhe emërtimit të shoqërive në rast të cënimit të të drejtave të pronësisë industriale, duke e deleguar këtë rregullim në akte nënligjore. Specifikisht, në zbatim të pikës 3 të nenit 23 të ligjit për QKR është miratuar VKM Nr. 537 esipërcituar.

Paragrafi 28 i VKM Nr. 537 shprehimisht parashikon se *“Çdo person i interesuar, në bazë të nenit 638 të Kodit Civil të RSH e të dispozitave, që rregullojnë pronësinë industriale, mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cënon një markë të regjistruar më parë apo emrat, emërtimet tregtare e shenjat dalluese të përdorura ligjërisht më parë nga të tretët (pavarësisht publikimit të tyre në regjistrin tregtar, sipas ligjit për QKR-në)”*.

Nga dispozitat në fjalë rezulton lidhja e emrit tregtar dhe emërtimit të shoqërive me të drejtat e pronësisë intelektuale, duke deleguar më tej në dispozitat e K. Civil (neni 638) dhe dispozitat specifike mbi pronësinë industriale me qëllim parashikimin e kriterëve përcaktuese dhe kushteve të zbatueshme lidhur me trajtimin e të drejtave të cënuara të një marke të mëparshme.

Sipas nenit 184/b të ligjit për pronësinë industriale dhe paragrafit 28 të VKM me Nr. 537 *pronari i një marke të mëparshme gëzon të drejtën për të kërkuar në rrugë gjyqësore ndalimin e përdorimit të paautorizuar të markës së tij si dhe ç'regjistrimin e emrit tregtar dhe emërtimit të shoqërisë të njëjtë apo të ngjashëm me markën e mëparshme.*

Pra, masat e parashikuara nga ligji për mbrojtjen e të drejtave të cënuara të një marke të mëparshme nga një emër tregtar apo emërtim i shoqërisë tregtare është procesi gjyqësor. Vlen për tu theksuar se siç parashikohet edhe shprehimisht në dispozitat ligjore më sipër, procesi i kundërshtimit të një emri tregtar dhe emërtimi të shoqërisë tregtare zhvillohet pavarësisht publikimit të këtij emri në Regjistrin Tregtar. Pra, të dhënat në Regjistrin Tregtar regjistrohen në mënyrë të pavarur nga të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Markave dhe kundërshtimi i këtyre të dhënave të publikura në Regjistrin Tregtar trajtohet dhe mbrohet nga ligji për pronësinë industriale, siç delegon edhe VKM Nr. 537 në paragrafin 28.

Më tej, ligji për pronësinë industriale, përpunon dhe rregullon specifikisht kriteret dhe kushtet sipas të cilave një emër tregtar mund të cënojë një shenjë/markë të mëparshme si dhe parashikon masat ligjore për rregullimin e cënimit dhe mbrojtjen e të drejtave të cënuara.

Në nenin 143/3 të ligjit për pronësinë industriale përcaktohet se të drejtat e pronësisë industriale të një marke të mëparshme cënohen nëse një emër tregtar është i njëjtë apo i ngjashëm thelbësisht me markën e mëparshme dhe pronari i këtij emri prodhon apo ofron mallra të njëjtë apo

të ngjashëm me mallrat e mbrojtura nga marka e mëparshme.

Kushtet sipas të cilave një markë e mëparshme çënohet nga një emër tregtar sipas dispozitive në fjalë janë: *a) njëllojshmëria ose ngjashmëria në thelb me markën e mëparshme; b) njëllojshmëria apo ngjashmëria e mallrave.*

Sa me sipër u analizua për të dyja markat, rezultoi se këto kushte ligjore plotësohen në mënyrë kumulative (bashkërisht).

Si konkluzion për palën paditëse, në rrethanat kur të dy kushtet e specifikuar nga ligji për pronësinë industriale janë përmbushur (shenjat pothuajse identike dhe mallrat identike), provohet dhe evidentohet qartësisht se përdorimi si emër tregtar dhe emër të shoqërisë së të paditurit çënon në mënyrë të pakontestueshme të drejtat e mëparshme të pronësisë industriale mbi markat Fast Dairy në pronësi të Paditësit.

Gjykimi i çështjes për palën e paditur u zhvillua në mungesë me shpallje pasi nga njoftimi i bërë nga gjykata në adresën e selisë së shoqërisë referuar ekstraktit të QKB-së rezultoi se « *është larguar nga kjo adresë* ». Në këtë mënyrë gjykata çmoi qëndrimin e kësaj pale pale në harmoni me provat e tjera.

Arsyetimi i gjykates.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazës ligjore të kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile përcaktohet se: *“Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehë mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”*. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se *“Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dypsozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës*. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: *“Gjykata duhet të shprehë për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm”*. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Nisur nga këto përcaktime procedurale, gjykata në analizë të pretendimeve të palës paditëse dhe provave të administruara në gjykim çmon se kerkese-padia duhet pranuar si e tillë për arsye të mëposhtme:

Në nenin 140 i Ligjit Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Për pronesinë Industriale” përcakton se:

“1. Çdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që shërben për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji (në vijim do të quhet “markë”).

2. Përbëjnë marka shenjat e mëposhtme:

a) fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtimet;

b) shenjat figurative, përfshirë vizatimet;

c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

ç) kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete;

d) çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike.

3. Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto.”

Neni 143 i Ligjit Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Per pronesine Industriale” percakton se: “1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.

2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:

a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;

b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëllojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;

c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t’u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshem, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.

3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:

a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;

b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;

c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;

ç) të drejtat e autorit të një vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;

ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.”

Në lidhje me sa u parashtrua më sipër, për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjykata çmon se është e nevojshme të zgjidhen çështjet juridike si vijon:

1. Cili është standardi i provueshmërisë në rastin e gjyimit të mosmarrëveshjeve në lidhje me regjistrimin e paligjshëm të markave që shkaktajnë konfuzion me markat e tjera të regjistruara më parë?
2. A ka në çështjen objekt gjykimi, mundësi për konfuzion midis markës tregtare “Fast dairy” dhe asaj “Fast Dairy”? Cila është pasoja që vjen në rast se ekziston ajo mundësi?
3. A është marka tregtare “Fast dairy” një marke e mirënjohur në Shqipëri ?
4. A permbushen kushtet ligjore për ç’regjistrimin e emrit tregtar dhe emrit të shoqërisë të paditur ***nga Regji stri Tregtar për shkak të ngjashmerisë pothuajse identike me markën e paditesit ?

Se pari: Sa i përket çështjes së parë të shtruar për zgjidhje në arsyetimin e këtij vendimi, gjykata vlerëson se standardi i të provuarit në mosmarrëveshjen objekt gjykimi, kërkon që pala paditëse të provojë regjistrimin e mëparshëm të markës së saj, si dhe regjistrimin e mëvonshëm të markës së pretenduar se krijon konfondim (ngatërrimit) me markën e mëparshme. Po ashtu, nga provat e paraqitura gjatë gjyimit, duhet të krijohet bindja se ekziston mundësia e konfondimit dhe jo vetë konfondimi. Mundësia e konfondimit është element që perceptohet nëpërmjet ushtrimit të një gjykimi sipas standardit mesatar të vlerësimit të një konsumatori në vendin dhe kohën në të cilën ndodh mosmarrëveshja. Vlerësimi i mundësisë së konfondimit, në kundërshtim sa pretendon pala e paditur, nuk mund të provohet me ekspertë, për faktin e vetëm se nuk ekzistojnë ekspertë në këtë fushë. Siç u tha, kriteri i vlerësimit është subjektiv dhe bazohet në vlerësimin e ndershëm të mundësisë që një konsumator mesatar, të konfondohet nga dy markat tregtare në fjalë. Mundësia e konfondimit është e vlerësueshme potencialisht, me një gjykim të arsyeshëm paraprak dhe për rrjedhojë mbi palën paditëse nuk rëndon barra që të provojë

ekzistencën aktuale të konfondimit të konsumatorit.

Në rastin konkret, duke marrë për bazë dy markat që i nënshtrohen gjykimit, gjykata vlerëson në mënyrë abstrakte, nëse ka mundësi që të krijohet konfuzion midis dy markave. Pra palët kanë detyrimit dhe barrën të provojnë plotësisht ekzistencën e të drejtave mbi markat e regjistruara, por jo edhe të provojnë mundësinë e konfuzionit të konsumatorit, pasi kjo vlerësohet në mënyrë abstrakte nëpërmjet vlerësimit të atyre kritereve që shërbejnë për përcaktimin nëse një markë është e ngjashme me një tjetër apo jo. Në vlerësimin e fakteve objekt gjykimi, gjykata mban parasysh në vlerësimin e kritereve të përcaktuara në ligjin e brendshëm (*p.sh. neni 143 i ligjit "Për pronësinë industriale"*) edhe konventat ndërkombëtare, si edhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Europiane, apo manualët e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (*duke mbajtur parasysh këtu edhe ligjin nr. 8993, datë: 30.01.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale"*). Kjo pasi gjykata i vlerëson këto të fundit, si burime autoritare, për interpretimin e kritereve dhe për vlerësimin e fakteve objekt gjykimi, sipas praktikës më të mirë ndërkombëtare.

Referuar *çështjes së dytë* të shtruar për zgjidhje në arsyetimin e këtij vendimi, gjykata vëren se marka tregtare "Fast Dairy" përbëhet nga shenja, fjale, ngjyra dhe aplikohet për mallra që janë të ngjashme me ato të markës "Fast dairy" të regjistruar më parë nga paditësi, ku për shkak të njëjlojshmërisë ose ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkakimit të ngatërrimit tek konsumatori, përfshirë këtu edhe mundësinë e bashkëlidhjes së markës "Fast Dairy" me atë "Fast dairy". Ky fakt bën që regjistrimi i markës "Fast Dairy" të jetë i paligjshëm.

Në arritjen e përfundimit lidhur me sa më sipër, gjykata mban parasysh se pjesa e publikut që rrezikon të konfondohet nga mallrat që mbajnë markën tregtare "Fast Dairy", është ajo tërësi konsumatorësh që përdorin për konsum personal ose tregtar, qumeshtin si produkt konsumi ushqimor (*pothuajse e gjithë popullata, pasi ky mall shitet lirisht për publikun në dyqanet e shitjes së lirë*). Kjo tërësi konsumatorësh nuk ka mundësi që të krahasojë në detaje produktet e secilës markë, por ballafaqohet me to në dyqane, duke mos pasur mundësinë që ta krahasojë atë me produktin që pak a shumë e mban mend. Konsumatori mesatar ka një kujtesë mesatare, ndaj këtu gjykata mban parasysh se edhe vetëm mundësia e krijimit të dyshimit tek konsumatori në lidhje me markën tregtare (*nëse Fast Dairy është pjesë apo e njëjta me Fast dairy që konsumatori do të blejë*), bën që të krijohet dyshimi i mundësisë së konfondimit.

Ngjashmëria e markës "Fast Dairy" me atë "Fast dairy" ekziston për shkak se ato janë pothuajse identike. Elementi verbal Fast i markes se të paditurit është dominant dhe i nxjerre në pah, nisur nga menyra se si marka është regjistruar. Perveç kesaj ai pozicionohet i qenderzuar ashtu siç gjendet edhe tek markat e paditesit, ai gjendet i stilizuar në menyre identike si tek regjistrimi i paditesit.

Në rastin tonë, nga ana vizuale elementi dallues midis markave në diskutim është elementi verbal FAST, i cili është vendosur në plan të parë pamor dhe zë pozicionin parësor/kryesor, duke patur shkallën më të lartë

vizuale, në krahasim me elementët e tjerë përbërës të markave në diskutim. Gjithashtu, fjala FAST ka karakter dominant, për shkak të madhësisë dhe ngjyrës së kuqe të shkronjave që janë të njëjta tek të dyja markat. Është kjo fjalë që krijon përshtypje tek konsumatori dhe mbetet në kujtesën e tij. Përdorimi i kësaj fjale identike nga i padituri në markën e tij e bën këtë markë konfuzisht të ngjashme me markën e paditësit.

Lidhur me pjesën tjetër të elementëve përbërës të markës së të paditurit – elementi verbal “*dairy*”, i cili gjendet gjithashtu edhe në markën e paditësit, ky element jep informacion lidhur me kategorinë e mallit dhe si i tillë është element me karakter përshkrues (*dairy* - blegtori). Gjithashtu, raporti i tij me pjesën tjetër të markës është i ulët, dhe si i tillë është element që mund të mos konsiderohet në krahasimin e shenjave.

Fraza “Dairy delights from Albania” (produkte bulmeti nga Shqipëria) e përdorur në markën e të paditurit, përbëhet nga fjalë që përcjellin informacion mbi llojin e produktit (*dairy delights* – produkte blegtorale) dhe mbi origjinën gjeografike të produktit (*from Albania* – nga Shqipëria). Këto fjalë përshkruese janë të përjashtuara nga mbrojtja e markës së të paditurit (siç konstatohet edhe në ekstraktin e DPPM pika 526 të depozituar në gjykatë).

Më tej, ngjyrat që mbrohen dhe përdoren nga i padituri në prezantimin e markës së tij janë të njëjtat me ngjyrat e mbrojtura dhe të përdorura në markën e paditësit, të tilla si: *e kuqe, e bardhë, blu*. Përdorimi i të njëjtave ngjyrave shkakton konfuzion tek konsumatori nga ana vizuale.

Së fundmi, dhe pse marka e kundërshtuar përbëhet nga elementë figurativë dhe është e stilizuar, ky fakt nuk luan një rol të rëndësishëm në përshtypjen e përgjithshme që kjo markë krijon, pasi rezultoi e qartë se çfarë mbetet për tu krahasuar është vetëm elementi verbal FAST, i cili shkruhet me të njëjtën ngjyrë dhe krijon të njëjtin efekt vizual tek të dyja markat.

Elementi që mbetet për tu krahasuar është elementi verbal FAST i cili është edhe elementi dallues nga pikëpamja vizuale ndër të gjithë elementët e tjerë, duke arritur në përfundimin se markat në diskutim janë konfuzisht të ngjashme.

Ngjashmëria midis markës “Fast dairy” dhe asaj “Fast Dairy” lidhet edhe më ngjashmërinë e madhe në shqiptim dhe në kuptimin që rrjedh nga fjalët e mësipërme dhe nga ky aspekt markat janë identike. Ato përbëhen nga të njëjtat fjalë FAST, fjalë e cila lexohet dhe shqiptohet nga konsumatori shqiptar njësoj. Prezenca e fjalës “*Dairy*”, për arsytet e shpjeguara më lart, mund të mos konsiderohet nga konsumatori, megjithatë edhe kjo fjalë përshkruese e mallit lexohet njësoj nga konsumatori (deiri). Përsa i përket frazës “Dairy delights from Albania” (produkte bulmeti nga Shqipëria), kjo frazë nuk gëzon mbrojtje nga marka e të paditurit.

Pra sa më lart, ngjashmëria e markave në diskutim është tepër e lartë. Kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 143/2/b të ligjit specifik janë përmbushur: mallrat e markës së të paditurit janë identike me mallrat e markës së paditësit (klasa 29- kategoria qumësht dhe nënprodukte të tij) dhe shenjat përbërëse të markave kanë një ngjashmëri ekstremisht të ngjashme, pothuajse identike. Në kushtet kur kemi mallra identike dhe

markat ekstremisht të ngjashme, mundësia për konfuzion është tepër e lartë dhe konsumatori konfondohet menjëherë. Për më tepër që me ngjashmërinë e tyre këto marka të krijojnë përshtypjen se janë të bashkëlidhura me njëra-tjetrën dhe vijnë nga e njëjta shoqëri, fakt që nuk është aspak i vërtetë.

Element tjetër që gjykata mban parasysh në vlerësimin e ngjashmërisë midis dy markave, është qenia identik e klasës së produkteve që ofrohen nën markën “Fast dairy” dhe asaj “Fast Dairy”, klasen 29 (qumesht dhe nenproduktet e tij, etj).

U provua në gjykim sipas shpjegimeve të pales paditese dhe provave të administruara, ekzistenca e ngjashmerive në amablazhime të produkteve të markuara, por edhe nese do të pranohet të kunderten, mungesa e ngjashmërisë në ambalazh, nuk ndikon në vlerësimin e mësipërm të gjykatës, pasi ambalazhi mund të jetë element aq fleksibël, sa konsumatori nuk bën dot në mënyrë cilësore dallimin. Kjo për faktin se emërtimi i mallit (*marka tregtare*) është elementi që përdoret më shpesh në komunikimin tregtar (*klient-shitës*) dhe markat e ndryshme mund të paraqiten me ambalazhe të ndryshme. Nga ana tjetër ambalazhi nuk rezulton të jetë element i mbrojtur i markës tregtare, por në rastin objekt gjykimi, elementë të mbrojtur janë vetëm emërtimet “Fast dairy” dhe asaj “Fast Dairy” (tek të dyja janë dhe elementet e ngjyrave që mbrohen). Logoja e “Fast Dairy delights from Albania” nuk shmang aspak konfondimin lingistik të parashtruar sa më sipër. Pasqyrimi grafik i markës “Fast Dairy”, sado që paraqitet i ndryshëm nga ai i “Fast dairy”, prapë se prapë, vlerësohet se nuk është në gjendje që të shmangë tërësisht mundësinë e konfondimit të publikut. Kjo pasi elementi kryesor i përfaqësimit të kësaj marke është emri i saj “Fast” dhe jo fjala “dairy” apo “delights from Albania” që konstatohet se është pjesë e logos së saj.

Sa më sipër, gjykata çmon se konform neneve 143, 156 e 167 të ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për pronësinë industriale”, marka tregtare “Fast Dairy” paraqet ngjashmëri të atillë me markën e regjistruar më parë “Fast dairy”, që mund të çojë publikun në ngatërrimin e tyre. Për këtë shkak, marka tregtare “Fast Dairy”, e regjistruar me Nr. *** dt. 18. 11. 2011 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave duhet të ç’rejistrohet dhe pala e paditurit shoqëria ***. të detyrohet që të ndërpresë përdorimin e mëtejshëm të kësaj marke.

Se treti: Kusht tjetër ligjor i mbrojtjes së markës tregtare është dhe mirenjohja e saj në vendin ku përdoret si e tillë. Neni 143 pika 5, germa “ç” e ligjit përcakton se: “Marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.

Kriteret ligjore të percaktuara më sipër në raport me Konventën që ti japin një marke statusin “marke e mirënjohur” kërkojnë nga gjykata që vlerësimin e tyre ta bëjë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin që kanë në vetvete këto terma të përdorura në ligj për raport me rrethanat

konkrete. Kështu koncepti “perdorim” nenkupton per gjykatën se *pari* perdorimin e saj minimalisht ne nje grup te caktuar te interesuarish dhe maksimalisht per publikun e gjere dhe se *dyti* kohezgjatja e ketij perdorimi perben kriter tjeter vleresues per gjykatën per dhenien e ketij statusi. Koncepti i “reklamimit ose publikimi” lidhet me evidentimin e kesaj marke nepermjet formave te ndryshme te te berit publike si reklama, spote publicitare, postera, flete-palosje etj. U provua gjyqesisht se kjo marke tregtare eshte e mirenjohur ne tregun shqiptar per sa kohe qe ajo si e tille eshte tregtuar qe nga viti 2010 nga shoqeria ***. Nga pala paditese perpos gjithë praktikave doganore, deklaratave te agjentit, kontratave te distribucionit apo te reklamave te sjella nder vite lidhur me importimin e ketyre produkteve ne tregun shqiptar nga shoqeria pronare e saj, u provua edhe fakti i qenies se kesaj marke dhe produktit qe ajo tregton si mall konsumi jetik i perditshem nga mbare popullata (konsumatori).

Ne gjykim u provua, se pala e paditur jo vetem ka inkorporuar karakterin dallues - elementin verbal Fast Dairy, por evidentohet gjithashtu se ai perdor paketime shume te ngjashme me te paditesit. I padituri eshte i pozicionuar ne treg si konkurrent i shoqerise ***, ai shet mallra identike nen nje marke qe klientet mund ta perceptojne si nje zgjatim te Markave Fast dairy. E gjitha kjo rezulton ne nje konfuzion ne treg, si dhe ne marrjen e perfitimeve nga reputacioni i markave te paditesit.

Ne lidhje me çështjen e fundit per diskutim, në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr. 9723, datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (QKR), të ndryshuar, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave me Nr. 537, datë 01. 08. 2007 “Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare”.

Neni 23 i ligjit për QKR dhe ligji në përgjithësi nuk rregullojnë shprehimisht dispozitat mbi ç’regjistrimin e emrave tregtarë dhe emërtimit të shoqërive në rast të cënimit të të drejtave të pronësisë industriale, duke e deleguar këtë rregullim në akte nënligjore. Specifikisht, në zbatim të pikës 3 të nenit 23 të ligjit për QKR është miratuar VKM nr. 537 esipërcituar.

Paragrafi 28 i VKM Nr. 537 shprehimisht parashikon se “Çdo person i interesuar, në bazë të nenit 638 të Kodit Civil të RSH e të dispozitave, që rregullojnë pronësinë industriale, mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cënon një markë të regjistruar më parë apo emrat, emërtimet tregtare e shenjat dalluese të përdorura ligjërisht më parë nga të tretët (pavarësisht publikimit të tyre në regjistrin tregtar, sipas ligjit për QKR-në)”.

Nga dispozitat në fjalë rezulton lidhja e emrit tregtar dhe emërtimit të shoqërive me të drejtat e pronësisë intelektuale, duke deleguar më tej në dispozitat e kodit civil (neni 638) dhe dispozitat specifike mbi pronësinë industriale me qëllim parashikimin e krietereve përcaktuese dhe kushteve të zbatueshme lidhur me trajtimin e të drejtave të cënuara të një marke të mëparshme.

Sipas nenit 184/b të ligjit për pronësinë industriale dhe paragrafit 28 të VKM me Nr. 537 pronari i një marke të mëparshme gëzon të drejtën për të kërkuar në rrugë gjyqësore ndalimin e përdorimit të paautorizuar të markës së tij si dhe çregjistrimin e emrit tregtar dhe emërtimit të shoqërisë të njëjtë apo të ngjashëm me markën e mëparshme.

Pra, masat e parashikuara nga ligji për mbrojtjen e të drejtave të cënuara të një marke të mëparshme nga një emër tregtar apo emërtim i shoqërisë tregtare është procesi gjyqësor. Siç parashikohet edhe shprehimisht në dispozitat ligjore më sipër, procesi i kundërshtimit të një emri tregtar dhe emërtimi të shoqërisë tregtare zhvillohet pavarësisht publikimit të këtij emri në Regjistrin Tregtar. Pra, të dhënat në Regjistrin Tregtar regjistrohen në mënyrë të pavarur nga të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Markave dhe kundërshtimi i këtyre të dhënave të publikura në Regjistrin Tregtar trajtohet dhe mbrohet nga ligji për pronësinë industriale, siç delegon edhe VKM Nr. 537 në paragrafin 28.

Më tej, ligji për pronësinë industriale, përpunon dhe rregullon specifikisht kriteret dhe kushtet sipas të cilave një emër tregtar mund të cënojë një shenjë/markë të mëparshme si dhe parashikon masat ligjore për rregullimin e cënimit dhe mbrojtjen e të drejtave të cënuara.

Ne nenin 143/3 të ligjit për pronësinë industriale përcaktohet se të drejtat e pronësisë industriale të një marke të mëparshme cënohen nëse një emër tregtar është i njëjtë apo i ngjashëm thelbësisht me markën e mëparshme dhe pronari i këtij emri prodhon apo ofron mallra të njëjtë apo të ngjashëm me mallrat e mbrojtura nga marka e mëparshme.

Kushtet sipas të cilave një markë e mëparshme cënohet nga një emër tregtar sipas dispozitve në fjalë janë: *a) njëllojshmëria ose ngjashmëria në thelb me markën e mëparshme; dhe b) njëllojshmëria apo ngjashmëria e mallrave.*

Në rastin konkret, Paditësi zotëron jo vetëm markën- fjalë&figurë Fast Dairy por edhe markën-fjalë Fast Dairy. Për efekt krahasimi me emrin tregtar dhe emërtimin e shoqërisë paraqesim më poshtë të dhënat si vijon:

Marka -fjalë e Paditësit

Emri tregtar dhe emërtimi i shoqërisë së të Paditurit

FAST DAIRY

Data e depozitimit: 24.06.2011

Data e regjistrimit: 11.11.2011

Klasa 29 – Qumësht dhe nënprodukte të tij

Objekti

aktivitetit: prodhimi dhe tregtimi i produkteve dhe nënprodukteve të qumështit, si qumësht, djathë, kos, gjizë, gjalp, ricota, mocarela, etj.

Marka-fjalë Fast Dairy (numër 1099276) është e vlefshme në Shqipëri duke filluar nga data 24. 06. 2011. Në një kohë kur shoqëria e të paditurit është regjistruar më datë 11 tetor 2011. Pra, rezulton se marka kundërshtuese gëzon të drejtat të mëparshme të pronësisë intelektuale në krahasim me emrin tregtar dhe emërtimin shoqërisë së të paditurit.

Paditësi me markën e tij të mëparshme mbron, ndër të tjera, klasën 29 – produkte të qumështit dhe nënproduktet e tij. Ndërkohë kur objekti i veprimtarisë së të paditurit është kryesisht prodhimi dhe tregtimi i produkteve dhe nënprodukteve të qumështit, si kos, gjalp, djathë, mocarela, gjizë dhe ricota, siç vërtetohet edhe nga ekstrakti i regjistrimit të shoqërisë *** lëshuar nga QKB.

Nga sa më sipër, rezulton se:

Nga krahasimi i markës së mëparshme Fast Dairy dhe fjalës Fast të përdorur si emërtim të shoqërisë dhe emër tregtar nga i padituri, duket fare qartë se janë çenuar të drejtat e markës së paditësit. Siç është shpjeguar dhe vërtetuar sa më sipër, elementi dallues dhe dominant i markave në diskutim është fjala FAST, pasi kjo fjalë për nga ana vizuale zë pozicionin parësor, dhe bie në dukje menjëherë kur shikon të dy markat në krahasim dhe madhësia e shkronjave të përdorura për këtë fjalë. Gjithashtu, nga ana konceptuale këto dy fjalë lexohen njësoj pasi edhe renditja e shkronjave është në të njëjtën mënyrë.

Rrjedhimisht, në krahasimin midis tyre, rezulton e qartë që fjala FAST e përdorur nga i padituri për emërtimin tregtar dhe të shoqërisë së tij është pothuajse identike me markën-fjalë të Paditësit.

Nga krahasimi i mallrave rezulton se ato janë identike, pasi siç rezulton edhe nga objekti i aktivitetit të shoqërisë së të paditurit, shoqëria Fast sh.p.k. ka të fokusuar veprimtarinë e saj për prodhimin dhe ofrimin për shitje të produkteve dhe nënprodukteve të qumështit, si kos, gjalp, djathë, mocarela, gjizë dhe ricota. Ndërkohë kur klasa e mbrojtur nga marka e mëparshme e paditësit është klasa 29 për kategorinë e gjerë të mallrave qumësht dhe nënproduktet e tij, që përfshijnë të gjithë produktet e cilësuar nga i padituri në objektin e aktivitetit të tij, duke koiciduar në terma si *qumësht, djathë, gjizë, kos, gjalp*.

Si konkluzion, në rrethanat kur të dy kushtet e specifikuar nga ligji për pronësinë industriale janë përmbushur (shenjat pothuajse identike dhe mallrat identike), provohet dhe evidentohet qartësisht se përdorimi si emërtim tregtar dhe emër të shoqërisë së të paditurit çënon në mënyrë të pakontestueshme të drejtat e mëparshme të pronësisë industriale mbi markat Fast Dairy në pronësi të Paditësit.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e gjen të bazuar padinë e palës paditëse, duke e pranuar atë sipas disponimeve të cituara ne dispozitivin e saj, si dhe duke urdhëruar, sipas parashikimit të nenit 184/b/ç/2 të Ligjit 9947/2008, publikimin e vendimit në Buletinin e Pronësisë Industriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave.

Për sa më sipër u analizua gjykata çmon se kërkesë-padia është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar ne Nenet 126, 306-308 e vijues te K. Pr. Civile,

VENDOSI :

1. Pranimin e kerkese-padise.
2. Ç'regjistrimin e markes tregtare Fast Dairy (fjale&figure) me regjistrim kombetar numer ***, regjistruar ne emer te te paditurit shoqeria ***.

3. Ndalimin e perdorimit te metejsheem te markes tregtare Fast Dairy nga i padituri shoqeria ***.
 4. Ç'regjistrimi i emrit tregtar dhe emrit te shoqerise se te paditurit *** nga Regjistri Tregtar prane QKB-se.
 5. Publikimin e ketij vendimi ne Buletinin e Pronesise Industriale te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave.
 6. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.
 7. Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane, brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e shpalljes se tij, per palen prezent dhe nga e nesermja e dites se komunikimit te vendimit per palen ne mungese me shpallje.
- 8. U shpall sot me date 27. 02. 2017 ne Tirane.**

SEKRETARE

GJYQ TAR

GENCJANA DADA

ERVIN POLLOZHANI

Shpenzimet gjyqësore

Taksë padie	***lekë
<u>Shpenzime njoftimi</u>	*** lekë
Totali	***lekë